

# ERVIN HOXHA

## Nëntor 2023, Kryeinspektor IKMT

Ka ndjekur një sërë trajnimesh të ndryshme në fushën e sigurisë e zbatimit të ligjit në SHBA, Austri, Gjermani e vende të tjera europiane. Për më shumë se 20 vite ka shërbyer në detyra të ndryshme shtetërore nga niveli ekzekutues deri në nivela të larta drejtimi në institucione qendrore të zbatimit të ligjit si Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë.

Ervin Hoxha ka shërbyer si drejtor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Policinë e Shtetit; Shef i Njësisë Kombëtare Europol; Shef i Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol; drejtor i Policisë Rrugore; drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; drejtor i Hetimit Tatimor dhe Pastrimit të Parave; zv.drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore; drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, si dhe drejtor Kabineti e këshilltar i disa funksionarëve të lartë të shtetit.

Aktualisht mban detyrën e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Ai është i martuar, dhe ka dy fëmijë.



Ka lindur në Tiranë me 13 Tetor 1978. Arsimin e mesëm e kreu në Balikesir të Turqisë. Më pas vijoi shkollimin në Akademinë e Sigurisë në Dresden të Gjermanisë. Në vitin 2006 përfundoi studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës. Arsimin pasuniversitar e kreu në Shkollën e Lartë të Policisë Gjermane në Münster duke fituar titullin MA në Administrim Publik dhe Menaxhim Policor. Zotëron në nivele të avancuara gjuhën turke, gjermane dhe atë angleze.